



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 687/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaqi kryesues, Faton Ademi dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e kandidatit për Kuvend Komunal të Kamenicës Fitim Gagica, nga Subjekti Politik Partia Socialdemokrate (PSD), paraqitur kundër anëtarëve të komisionit komunal të vendvotimeve: 1032D/01R, 1032D/02D, 1006D/01D, 1008D/02D, 1008D/01R dhe 1001D/01R, për shkak të parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve, për Zgjedhjet Lokale 2021, të mbajtura më datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 20.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHEN të pa lejuara ankesat: Anr.687/2021, Anr.688/2021, Anr.689/2021 dhe Anr.690/2021, të gjitha të datës 18.10.2021, paraqitur nga kandidati për Kuvend Komunal të Kamenicës Fitim Gagica, nga Subjekti Politik Partia Socialdemokrate (PSD), paraqitur kundër anëtarëve të komisionit komunal të vendvotimeve: 1032D/01R, 1032D/02D, 1006D/01D, 1008D/02D, 1008D/01R dhe 1001D/01R, për shkak të parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve, për Zgjedhjet Lokale 2021, të mbajtura më datës 17.10.2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.687/2021, Anr.688/2021, Anr.689/2021 dhe Anr.690/2021, të gjitha të datës 18.10.2021, paraqitur nga kandidati për Kuvend Komunal të Kamenicës, Fitim Gagica, nga Subjekti Politik Partia Socialdemokrate (PSD), paraqitur kundër anëtarëve të komisionit komunal të vendvotimeve: në VV 1032D/01R dhe VV 1032D/02D, pretendon se ka pasur mungesë të votave sepse sipas Formularëve të publikuar ka vetëm 1 votë, ndërsa sipas të afërmeve e tij pretendon se ka mbi 15 vota. Në VV 1006D/01D, pretendon se nuk iu kanë bartur saktë votat në Formularin e Rezultateve për Kandidat-FRK, nga 30 vota të fituara janë shënuar vetëm 10 vota. Në VV 1008D/02D dhe 1008D/01R parashtruesi i ankesës pretendon se nuk iu janë bartur votat në Formularin e Rezultateve për Kandidat-FRK, gjithsej 25 vota dhe në VV 1001D/01R iu janë përshkruar vetëm 8 vota, ndërsa pretendon se ka fituar më shumë vota.

Si dëshmi për këtë ankesë i ka bashkangjitur fletët llogaritëse për kandidat për Zgjedhjet e Kuvendit Komunal..

Paneli, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesat janë të pa lejuara

Paneli, paraprakisht ka vlerësuar se ankesat: Anr.687/2021, Anr.688/2021, Anr.689/2021 dhe Anr.690/2021, kanë përmbajtje dhe natyrë të njëjtë të shkeljes së pretenduar, paraqitës i të gjitha ankesave është kandidati për Kuvend Komunal të Kamenicës, Fitim Gagica, nga Subjekti Politik Partia Socialdemokrate (PSD), dhe po ashtu të njëjtat janë paraqitur kundër parregullsive në Qendrat e Votimit, prandaj Paneli, bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”*, bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesa përkitazi me parregullsitë në qendrat e votimit në 1032D/01R, 1032D/02D, 1006D/01D, 1008D/02D, 1008D/01R dhe 1001D/01R, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hedhë si të parakohshme ankesat e ankuesit. Hedhja e ankesave të kandidatit Kuvend Komunal të Kamenicës, Fitim Gagica, nga Subjekti Politik Partia Socialdemokrate (PSD), nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Paneli duke u mbështetur në Rregulloren Nr.02/2015, përkatësisht neni 6.4, me të cilën përcaktohet se: *“ankesa të cilat janë të pa lejuar dhe të pas afatshme PZAP-i, hudhë si të pa lejueshme”* ankesa është e palejueshme për faktin se është paraqitur para afatit të paraparë ligjor.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe nenit 6 paragrafi 4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 687/2021 më datën 20.10.2021**



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa ne afat prej 24 orëve ne Gjykatën Supreme te Kosovës.